



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 430/4 Prot

Tiranë, më 22.07.2020

**V E N D I M**

Nr.84, datë 22.07.2020

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën nr. 430 prot., datë 26.5.2020, të nëpunëses \*\*\*\*\*,  
në lidhje me transferimin e përhershëm të saj pas ristrukturimit të institucionit Agjencia Rajonale e Bregdetit Lezhë**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës me nr. 430 prot., datë 26.5.2020, të përcjellë nga nëpunësja \*\*\*\*\*,  
në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së transferimit të përhershëm të saj në kuadër të ristrukturimit të institucionit,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet kërkesës nr. 430 prot., datë 26.5.2020, punonjësja \*\*\*\*\*  
aktualisht nëpunëse civile në institucionin Agjencia Rajonale e Bregdetit Lezhë, ka informuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me pretendimin për verifikimin e transferimit të përhershëm të saj në kuadër të ristrukturimit të institucionit në pozicionin, “Specialist në Sektorin e Monitorimit dhe Inspektimit të Zonave Bregdetare dhe Veprimtarive Turistike”, në Agjencinë Rajonale të Bregdetit Lezhë, kategoria e pagës IV-b, pasi ky pozicion pune ka ndikuar në uljen e kategorisë së pagës

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, rezulton se, struktura e re Agjencë Kombëtare të Bregdetit, e miratuar me Urdhërin nr. 25, datë 3.2.2020, të

Kryeministrit, *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”*, ka pësuar disa ndryshime, si në drejtim të emërimit, nga Degë Rajonale të Agjencisë së Bregdetit, në Agjenci Rajonale të Bregdetit, ashtu dhe në drejtim të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës. Një ndër ndryshimet e dukshme që është shënuar në Agjencitë Rajonale të Bregdetit me strukturën e fundit është fakti që, pozicioni i punës *“specialist”*, tashmë do ta ketë pagën kategoria IV-b (nga IV-a që e kishin pagën, *specialistët në strukturën e mëparshme*).

Në kushtet e zbatimit të strukturës së re, institucioni Agjencia Kombëtare e Bregdetit bashkë me Degët Rajonale të saj, është përfshirë në procesin e ristrukturimit, duke filluar me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit sipas Urdhërit nr. 17, datë 13.2.2020, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe shkrirjes së Inspektoriatit të Mjedisit Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”*, si dhe administrimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Në përfundim të këtij procesi, me propozim të Komisionit të Ristrukturimit, njësia përgjegjëse (*Departamenti i Administratës Publike*) me aktin nr. 1890/27 prot., datë 29.4.2020, *“Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”*, vendosi që, nëpunësja \*\*\*\*\* të transferohet nga pozicioni *“Specialist në Degën Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Lezhë”*, kategoria e pagës IV-a, në pozicionin, *“Specialist në Sektorin e Monitorimit dhe Inspektimit të Zonave Bregdetare dhe Veprimtarive Turistike”*, në Agjencinë Rajonale të Bregdetit Lezhë, kategoria e pagës IV-b.

Referuar këtij akti, Komisioneri vlerëson që transferimi i nëpunëses në fjalë, është realizuar në një pozicion të shërbimit civil, brenda të njëjtës kategori, (*kategoria ekzekutive*), në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar.

Bazuar në dispozitën e mësipërme, në ato raste kur për shkak të ristrukturimit pozicioni i punës nuk ekziston më, apo nuk përmban karakteristikat e mëparshme, lind detyrimi që njësia përgjegjëse të bëjë transferimin e nëpunësit që preket nga ky proces, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të të njëjtës kategori, sipas konceptimit që i bën këtij elementi të marrëdhënies së punës në shërbimin civil, pika 2, e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar.

Në këtë vështrim, në rastin e nëpunëses \*\*\*\*\* Komisioneri vlerëson se, duke qenë nëpunëse e nivelit ekzekutiv, mund të transferohet në një pozicion të kategorisë ekzekutive, pa e lidhur këtë me ndonjë detyrim apo element të një natyre tjetër, si paga, kushtet e punës, etj.

Rregullimi i problemit të pagesës dhe niveleve të pagës, bazohet në nenin 34, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në pikën 2 të të cilit përcaktohen përbërësit e pagës: “Paga e nëpunësit civil përbëhet nga paga bazë e kategorisë, shtesa për klasën së cilës i përket pozicioni, dhe shtesa për kushtet e punës”, ndërsa në pikën 4, të po këtij neni, përcaktohet kompetenca e organit që përcakton strukturën dhe nivelin e pagës për çdo pozicion, duke përcaktuar shprehimisht: “Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore për strukturën dhe nivelet e pagave sipas këtij neni”, kompetencë e cila materializohet, për çdo rast dhe institucion, nëpërmjet urdhërave të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave.

Ky është kuptimi që i jep ligji detyrimeve të institucionit për ruajtjen e statusit të nëpunësve civilë, në rastet kur pozicionet e tyre preken nga ristrukturimi. Nisur nga parimi kushtetues, i shpërblimit sipas sasisë dhe cilësisë së punës, kuptohet që një nëpunës kur pranon të punojë në një pozicion pune të shërbimit civil, qoftë në momentin e pranimit në shërbimin civil, ashtu dhe në rastin e transferimit në një pozicion tjetër të të njëjtës kategori, për shkaqe ligjore, është i detyruar të marrë parasysh që do të paguhet sipas pagës së përcaktuar nga organi kompetent për atë pozicion pune. Organi kompetent për përcaktimin e pagës për pozicionet e punës është Këshilli i Ministrave, i cili nxjerr aktet e nevojshme nënligjore për strukturën dhe nivelet e pagave, të cilat siç u tha dhe më lart, materializohen nëpërmjet urdhërave të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagës për çdo institucion dhe pozicion konkret pune.

Pra, ashtu sikundër u theksua edhe më sipër, Komisioneri vlerëson se transferimi i nëpunëses \*\*\*\*\*, është realizuar në përputhje me ligjin, si dhe me strukturën dhe organikën e institucionit të miratuar me Urdhërin nr. 25, datë 3.2.2020, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”. Ndryshimi i pagës në këtë rast, nga klasa IV-a në IV-b, nuk i ndryshon nëpunëses kategorinë, pasi të dyja këto kategori pagash i përkasin kategorisë ekzekutive, “specialist”, qëndrim të cilin e ka mbajtur edhe Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në përgjigjen që i kanë dhënë ankesës së nëpunëses \*\*\*\*\*, në lidhje me rishikimin e aktit të transferimit të saj.

Nga sa është parashtruar më sipër, në analizë të dokumentacionit të administruar dhe fakteve të çështjes konkrete, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se pretendimi i nëpunëses \*\*\*\*\*, që në kuadër të ristrukturimit të institucionit, është transferuar në një pozicion pune me pagë më të ulët, është i padrejtë.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “Mbi

*procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**VENDOSA:**

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 430 prot., datë 26.5.2020, të nëpunëses \*\*\*\*\*, në lidhje me pretendimin për uljen në kategorinë e pagës, pas transferimit të përhershëm të saj në kuadër të ristrukturimit të institucionit në pozicionin, “*Specialist në Sektorin e Monitorimit dhe Inspektimit të Zonave Bregdetare dhe Veprimtarive Turistike*”, në Agjencinë Rajonale të Bregdetit Lezhë, kategoria e pagës IV-b.
2. Të njoftohet për këtë vendim Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**